

VENDIM
Nr.1531, datë 19.11.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM,
TË KOMUNËS OROSH TË QARKUT TË LEZHËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Orosh të qarkut të Lezhës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Orosh të qarkut të Lezhës, miratuar me vendimin nr.163, datë 13.2.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Orosh, të qarkut të Lezhës”.

2.Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Orosh për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Orosh

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-18	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
22-31	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
19	Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën administrative.	Në pronësi
20,21,851,851	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
32-40	Varrezat publike.	Në pronësi
46,858-867,869-884	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike).	Në pronësi
41,42	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
755-758,763-766,771,772,777-780,785-787,792-794,799-801,806-808,812-814,818-820,825-827,831-833,837-	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim

839,843,844		
759-762,767-770,773-776,781-784,788-791,795-798,802-805,809-811,815-817,821-824,828-830,834-836,840-842,845,846-850	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive).	Në pronësi
857	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile.	Në pronësi
885-891	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi